



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep.	Dep.	Dep.	2-D /DPK
Nr. i faq.			
Broj stranica	03		
Nr. pages			
Data			
Datum			
Date			
PRISHTINE			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	01.10.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	zpj. Mimoza Kusari – Kryetare në Komunën e Gjakoves
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit <i>H. Preteni</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik

E nderuar zpj. Kusari-Lila,

Lidhur me kërkesën tuaj drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit (DPK-03-3575/14), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me çështjen e konfliktit e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshmë Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), Agjencia kundër Korrupsionit, ndër të tjera, bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eproreve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave (neni 19, pika 1.5).

Prandaj, duke u përgjigjur pyetjes tuaj konkrete se a paraqet konflikt te interesit pjesëmarrrja e juaj si kryetare e Komunës (Zyrtare e larte Publike) në cilësinë e vëzhgueses gjatë intervistimit te kandidateve për Drejtor të Bordeve te Ndërmarrjeve Publike lokale te Komunës se Gjakovës nga Komisionet e Aksionarëve.

Agjencia kundër Korruptionit si institucion kompetent lidhur me parandalimin e konfliktit të interesit ne ushtrim te funksionit publik, në bazë te Ligjit Nr. 04/L-050 nxjerr këtë:

O P I N I O N

Pjesëmarrja e juaj si kryetare e Komunës se Gjakovës (Zyrtare e larte Publike) në cilësinë e vëzhgueses gjatë intervistimit te kandidateve për Drejtore të Bordeve te Ndërmarrjeve Publike lokale te Komunës se Gjakovës nga Komisionet e Aksionarëve, nuk paraqet konflikt te interesit dhe nuk është e ndaluar me ligjin në fuqi, mirëpo është obligim i çdo zyrtari qe te shhang çfarë do situate të mundshme të konfliktit te interesit.

Arsyetim


Agjencia kundër Korruptionit është institucion i pavarur të cilit me ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bën edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve qe kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara me ligj.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejmë Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit). Situata për te cilën ju keni pyetur shprehimisht nuk është e përcaktuar ne Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Sipas nenit 6 te ligjit Nr. 04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Konflikti i interesit - është gjendja e mospjatimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, te cilat ndikojnë, mund te ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Në bazë të nenit 7.6 të këtij ligji thuhet se : Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk ka të drejtë të krijojë marrëdhënie varësie nga persona tjerë që do të mund të ndikonin në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimmarrje.

Po ashtu edhe në piken 8 të këtij nenii zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shhang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm, ndërsa sipas nenit 8 të këtij ligji, te gjithë zyrtaret e lartë kanë detyrë qe te parandalojnë konfliktin e interesit dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.



E nderuar znj. Kusari- Lila, Bazuar në atë qe u tha me lartë lidhur me çështjen e ngritur nga ana e juaj si dhe në bazë te ligjit në fuqi, ju rekomandojmë qe te ndërmerrni te gjitha masat konform këtij opinioni si dhe në bazë te kompetencave tuaja si institucion ta konsultoni dhe të bazoheni në ligjin mbi ndërmarrjet publike, ligji mbi administrimin e pushtetit lokal si dhe me statutin e komunës se Gjakovës.

Me respekt!

